

INTERVISTË ME MEMEDALI GRADINA

Prishtinë | Data: 24 korrik, 2019

Kohëzgjatja: 86 minuta

Të pranishëm:

1. Memedali Gradina (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Çfarë kujtime keni prej fëmijërisë?

Memedali Gradina: Ma së pari me prezantu vetën, unë jam Memedali Gradina banor i Janjevës. Kom banu këtu në Janjevë prej zvogëlimit sa e di vetën, prej 6 vjeçar deri në 11 vjeç. Mandej, jom dalë jashtë në Francë me familjen. Jom kthy në '86-tën këtu në Kosovë, domethanë në Janjevë. Janjeva përpara, si iu thashë, u kanë *Parisi i Vogël*, qashtu bile e thirrshum. Janjeva u kanë e njoftun për nifarë suxhuku të Janjevës.

Vishin prej kah mosit, domethanë të Kosovës edhe jashtë Kosovës vishin veç, sebeb [shkaku] qata suxhuk. E qashtu u njoftë Janjeva, cili vend o, prej qatij suxhukit që u marojke këtu, a kroatët normal. Përpara ktu, Janjeva ka pasë 7.500 banorë, domethanë, komplet po flas, komplet 7.500 banorë me shqiptarë, me kroatë, me romë, me boshnjakë, me turkë.

Serbë s'kena pasë këtu në Janjevë kurrë edhe sot e asaj ditë s'ka. Janjeva, qysh m'kujtohet mu, qysh i thashë, Paris i Vogël si fëmi e mbaj në mend kur dilsha, shtatë vjeçar, Janjevë në qendër, qashtu këta kroatët merrshin diçka ndonjë harxh për shtëpi, i çojsha ato keset, une ditën e nxjerrsha. Domethanë, qaq u kanë Janjeva e fortë përpara, qato vite, domethanë prej '75-tës qashtu diçka, Janjeva...

Anita Susuri: A iu kujtohet qyteti?

Memedali Gradina: Qyteti nuk ka ndryshu absolutisht hiç, veç u prishë, normal u prishë... ju bovaki [ndoshta] jeni sillë ktu nëpër Janjevë e keni pa sa shtëpia janë rrxu e sene se e kanë lshu kroatët që kanë shku. Jo pas luftës po edhe para luftës kroatët janë shku. Nejse, tana ma lufta e ka bo t'vetën edhe ma shumë, po para luftës këtu Janjeva ka njeh njo tetë a nantë kafe edhe shtatë tetë kafiqa.

E mbajsha në mend kur dilsha kështu me fitu naj dinarë normal, kur hisha nëpër kafe, nëpër kafiqa verës s'ka pasë njeri vend as ku me u ulë bile. Ulëse s'ka pasë me u ulë. Po nejse pak... tana ka nisë me blloku qysh u kanë, mos me ia përmend emrin ma mirë hiç se na ka lanë ni shenjë bajagi n'zemër.

Qysh u hi ai [Shesheli] në Janjevë qashtu tani kroatët kanë nisë me dalë, edhe prej qatëherit ma Janjeva ka nisë me u shymë.

Anita Susuri: Shesheli apo?

Memedali Gradina: Po, Shesheli, tana Janjeva ka nisë me u shym.

Anita Susuri: Kthehna pak te, kur keni qenë ju i vogël edhe familja juj me çka u marrë? Me çka ka punu baba juj?

Memedali Gradina: Baba jem ka punu ktu te kroatët se në të shtetit s'ka pasë, po nejse ka pasë ni kohë edhe sot e atë ditë është nifar' fabrike Metallci po atëhere ka vy me pasë naj daj a naj sebeb me hi aty. Sikur tash, kërkah nuk u ndrru, hiç, normal. E qatëherë baba jem punojke qashtu te kta kroatët me ata maqinat që prodhojshin lodrat për fmi e me pllantikë që janë marrë shumë.

Nana jeme te ni mishtore qaty e mushke suxhuk të Janjevës që e përmenda parzit. E qashtu na majshin neve, se na jena dy vllazni edhe tri motra. Nejse, qatëherë jemi konë bajagi të vogël ama shtatë anëtarë në shpi plus babgjyshi e gjyshja e mixhat kena jetu në ni shtëpi. Poshtë është ajo shtëpi. Domethanë, dy dhoma edhe kena jetu 27 anëtarë përpara. Po, kapak kapak qashtu tani erdh koha... baba jem u shku në Francë ma së pari vet.

Nejse, na këtu ia nisëm shkollë. Une shkollë, motra shkollë, ata hala t'vogël janë kanë. Po apet jeta u kanë shumë ma e mirë se qetash. Qato që i fitojshim, qato që i hajshim u kanë ma i shishëm se tash. Për shembull, se tash gjinja s'kanë vullnet për jetë ma. Përpara, ne si fëmi, njimdhetë vjet, dymdhetë vjet, fëmi, dhetë vjet, neve s'na interesojke kurgjo veç me pasë pak pare sa me shku në shkollë me mësu. A qitash me pyt nëpër rrugë qata rininë, s'kanë vullnet për jetë ose për punë. Përpara njo punojke, 25 e honkshin. Qitashiti u ardhë koha 25 me punu dhetë s'mujnë me hangër.

Anita Susuri: Ju e përmendët babën e juj që ka punu në punëtori te kroatët?

Memedali Gradina: Po, në punëtori te kroatët.

Anita Susuri: A mundeni me na tregu, për shembull qysh kanë qenë ato punëtoritë? Cila shtëpi kroate ka pasë punëtori? Kush ka punu? A kanë punu veç ata vet a kanë marrë dikond?

Memedali Gradina: Kroatët, bon vaki, pakica prej atyne s'kanë pasë maqina, shumica po. Shumica prej shpive kanë pasë. Edhe normal, e merrshim prej secilës shpi të romëve këtu janë kanë tu punu te ata. Edhe ka pasë njo tri a katër shpi që punojshin edhe në "Metallac", po shumica prej romëve punojshin te ata.

Na ua kena pa hajrin shumë atyne kroatëve se e majshin... edhe sot e atë ditë janë dy familje këtu, janë disa shtëpi të romëve që punojnë te ata. Une për veti kom punu, veç e kom lshu punën. Nejse, përpara shumica shtëpi të kroatëve kanë pasë maqina edhe ata kanë pasë punëtori, po punëtoritë në

shtëpi. Për shembull, e kanë pasë një pjesë punëtorinë e qatë banojshin edhe jetojshin qatë. Na jepshin në rrogë për punëtorin edhe ata punojshin.

E tana me në vakt, baba jem, kur ka fillu me maru këtë shtëpi i ka marrë bajagi do për prej atij gazdës, a pronarit, qysh me thanë? E kanë marrë do për me fillu me ndërto këtë shpinë që jena momentalisht këtu. E tana ka vë me hy në punë krejt aty me femi, me nanën, me krejt. Tana e ka prurë, edhe bash në këtë dhomë këtu që jemi momentalisht u kanë si punëtori përpara.

E kem pasë këtu një dy maqinë t'vogla që punojshim, ne jse do ma të mdhoj punojshin në maqinë na e marojshim, e ndërtojshim do shnolla për femi, për flokë qysh me thanë, ato përpara, ne jse ju jeni të reja s'e di a e keni mrrë ato si tetshe janë kanë me në bisht që i mshelshin floktë përmas.

E marojshim qatë e marojshim kuklla për femi si lodra, si rraça si... qisi sene e tani dilshim kah gjysë, tana na i lepitshim qatë. Te shtëpia na i montojshim, ata i marojshin, na i montojshim edhe qojshim me paketa te ai pronari atje që me fitu pak ma shumë për edhe me la borxhin. Se normal, baba jem u hi në borxh për me nisë me maru shtëpijen.

Anita Susuri: Çfarë moshe keni qënë ju atëherë?

Memedali Gradina: Qysh?

Anita Susuri: Çfarë moshe keni qënë kur keni punu?

Memedali Gradina: Une kom pasë atëherë shtatë vjet. Shtatë vjet i kom pasë, po ne jse vllaznitë e babës tem edhe sot ata janë bajagi ndërmjet veti, qysh me thanë, njëni tjetrit i ndihmojnë edhe... e qatëherë janë kanë, ne jse, bashkë ata, me në shtëpi jetojshim. Poshtë është ajo shtëpia, tash s'është kërkush aty. Ata i nimojshin domethanë, mixhat e djemtë e mixhës, na kapak punojshim hiç, hiç, bile një dhetë punëtorë jemi kanë këtu që punojshim e fitojshim. Mashallah fitojshim mirë.

Anita Susuri: A keni punu veç me plastikë a edhe me metale?

Memedali Gradina: Edhe me metale punojshim, ato si feder i marojshim kështu shnollat, mandej i kthejshim e bojshim tetshin. E punojshim edhe me metale po shumica me plastikë. Shumica me plastikë.

Anita Susuri: Ju tregutë që edhe nana juj ka punu në mishtore...

Memedali Gradina: Po, mishtore.

Anita Susuri: Tregutë që Janjeva ka qënë e famshme për mishin, për suxhukun. A ju kujtohet diçka për qatë mishtoret? Ku kanë qënë ato? Kush i ka mbajtë?

Memedali Gradina: Kroatët, kroat u kanë edhe ai që e ka pasë atë mishtore. Pronari u kanë kroat. Edhe e ka pasë edhe në qendër që e shitke mishin e suxhukun që e pjeke, skarën e ka pasë e krejt. Punëtorinë e ka pasë këtu poshtë. Unë e di se shkojsha kur u untojsha, drejt me kallxu, shkojsha deri te nana aty. E kqyrsha qysh e marojke suxhukin e shtijke me u terë, hala pa u terë, ajo m’thojke... ni copë kështu m’jepke për me shku me hangër bukë.

Normal, përpara u kanë fukurallaku, po nejse përpara u kanë fukurallaku i omël a qitash osht’ fukarallak, qysh me thanë, bajagi bajat. Qe këtu në Janjevë, momentalisht, p’i kthehna. Sot asaj dite, p’e lojmë pak ata... momentalisht s’ka me thanë prej romëve tri a katër shpi që domethanë e kanë kështu jetën e mirë.

Kqyre tash jetën e mirë, çka domethanë jetën e mirë? Jetën e mirë, tash une për veti, shoqja punon une pa punë, po apet duhet me thanë, elhamdulillah [faleminderit]! Se qata që e ka dikush s’e ka as qata. Nana jeme e merr ni penzi 90 euro, e ka qat’ penzi, shoqja e merr qat’ rrogën arsimtari osht’ mësuse tu punu këtu në Janjevë po elhamdulillah [faleminderit], mirë është.

Anita Susuri: E qysh ka qenë për komunitetin romë atëherë para kur keni qenë ju ma i ri, fëmi kur keni qenë, qysh ka qenë jeta atëherë?

Memedali Gradina: Po qyre përpara këtu Janjeva, qysh e kom përmend duhet me përmend apet u kanë Paris i Vogël. Kërkush nuk kqyrke çka je e tek je. Na këtu edhe sot e atë ditë, na këtu po jetojmë si vllazni, pa marrë parasysh a është rom, a shqiptar, a osht’ turk. Na edhe sot e atë ditë jena edhe që atëherë jetojshim... unë si fëmi e mbaj në mend që neve s’na interesojke jashtë Janjevës çka ndodhke.

Na jetojshim këtu në Janjevë, vllaznimi-bashkimi, qysh thotë ajo fjala. Edhe kur marojke dikush, shembull, me nderë me thanë, ni novojtore me maru dikush, ni banjo me maru, na shkojshim krejt me i ndihmu. E tash për tash ni kese me ble kërkush s’ta bjen deri naltë pa i pagu.

Anita Susuri: Ju... deshta me iu vetë për komunitetin romë, m’tregutë që... moti atëherë edhe pronarët e kanë fol gjuhën rome me punëtorët që i kanë pasë, domethanë edhe kroatët e kanë fol. A është e vërtetë kjo? A iu kujtohet?

Memedali Gradina: Kqyre, këta kroatët që e kanë shtëpi nëpër mahallë këtu të romëve, normal ata e kanë fol gjuhën e romëve ma mirë se na romët që e folim. Edhe qata pronarët, normal e msojshin po nuk janë veç kroatët që e folin gjuhën rome. Qetash me dalë në qendër, në çarshi ka plot shqiptarë që e folin gjuhën rome. E për qita edhe si iu thashë na edhe para luftës edhe pas luftës na jem këtu si vllaznimi-bashkimi. Na s’kena pasë kurfarë probleme këtu, as gjatë luftës, as kufarë probleme s’kena pasë.

Anita Susuri: Sa i përket qytetit, a iu kujtohen ato kafet, janë “Bash Çarshia”, e është nifarë kafe aty afër “Bash Çarshisë”?

Memedali Gradina: Po.

Anita Susuri: A iu kujtohen? A kanë qenë edhe atëherë?

Memedali Gradina: Po, ajo “Bash Çashia” osht’ bajagi me thanë... ajo po m’doket kur visha une në pushim qatëherë u çelë “Bash Çarshia”, se su kanë, po u kanë bash tash ku është furra. S’e di a jeni kanë në qendër? Ku është furra ma së pari qaty kafja u kanë, domethanë kur jom kanë une bash i vogël, shtatë vjeçar, a tetë vjeçar kur i kom pasë ni kroat e majke qat’ kafën aty. Tani u kanë ni kafe knena naltë e ma naltë tana... nuk e dini Janjevën me iu tregu sa kafe ka pasë. Bajagi do kafe edhe do kafiqa ka pasë për rini.

Anita Susuri: E në cilin vit iu kujtohet që hapet “Bash Çarshia”?

Memedali Gradina: “Bash Çarshia”, qaty dikun po m’doket në fillimin e ‘80-tës qashtu dikun.

Anita Susuri: A ka qenë pronari kroat, a shqiptar, a?

Memedali Gradina: Jo, pronari kroat u kanë aty. Ai ka pasë edhe mishtoren e ka pasë, e ka pasë edhe mishtoren e ka pasë edhe qat’ kafen. E marojke edhe suxhukin e Janjevës ai e marojke. Ai e ka çelë qat’ kafe. E tana pas luftës e ka ble, ata janë turqeli po më duket që e kanë ble kafen. Edhe ngat atina ku osht’ xhamia, në qoftëse e keni pa në oborrin e xhamisë edhe qaty ka pasë ni kafe masnej xhamia e ka ble atë tokë.

Anita Susuri: E një kafe që është aty afër, e vjetër, 1928 a ju kujtohet? Aty tregojnë që nihere ka qenë kafe tani dyqan...

Memedali Gradina: Përballë “Bash Çarshisë”?

Anita Susuri: Po.

Memedali Gradina: Po, përballë “Bash Çarshisë” aty u kanë kafja e shtetit. Aty u kanë kafja e shtetit. Aty ka pasë edhe kangëtare sene, aty ka pasë... po m’kujtohet se qysh jo, m’kujtohet se une 55 vjet...

Anita Susuri: A keni qenë aty? Qysh ka qenë atmosfera?

Memedali Gradina: Po atmosfera u kanë, qysh me thanë, qajo atmosferë ma nuk kthehet kurrë, qajo atmosferë ma nuk kthehet kurrë. Aty ajo kafe u kanë plot, gjithë. Ka pasë muzikë, ka pasë kangëtare, aty shkojshin edhe pleq edhe t’ri edhe këta t’mesmës... kush ka mujtë ka hi mrena, kush ka pasë pare normal. Pa pare s’mundesh me hi në kafe me pi. Po aty nuk kqyrshin, për shembull a janë kanë kroat, a janë kanë rom, a janë kanë shqiptar, jo, jo. Aty pa marrë parasysh, aty u ulshim pijshim krejt bashkë. Krejt bashkë, s’ka pasë kurfarë problemi. Po qajo kohë s’më merr mendja që kthehet, se aty u kanë bash jeta e shijshme, jeta e omël.

Anita Susuri: Ju keni fillu shkollën në “Vladimir Nazor” apo?

Memedali Gradina: Po, “Vladimir Nazor” u kanë qatëherë.

Anita Susuri: A keni ndonjë kujtim prej asaj kohe?

Memedali Gradina: Po shkoja në shkollë aty. Janë kanë, mësus janë kanë shumica serbë. Normal, ata janë kanë shumica, ka pasë edhe mësus kroatë. Nejsë, qatëherë u kanë serbo-kroat shkolla, po nejsë edhe shqiptartë shkojshin veç që jemi kanë të ndame. Shkolla si shkolla... që bile bash atëhere, nejsë tash gjyna është me fol edhe sot e asaj dite s’kam problem me shkollë, po qatëherë na kur dilshim kështu pushimi i vogël, pushimi i madh krejt bashkë jemi konë. Se shembull, qato që i merrshim... përpara s’ka pasë qaq pare me ble nëpër çarshi si tash që ka smoka nëpër rrugë po gjujnë, atëherë s’ka pasë. Po na e merrshim, shembull, prej shpijes naj sanduiq naj sen me veti në shkollë. Dikush harrojke me marrë ja s’ka pasë, na i dajshim ato. S’ka pasë shansë njani me hangër, njani me kqyrë. Sikur tash, ai po shkon me ble ni smok për veti ai që s’ka as s’pe lutë me i thonë, “Merre bre pak”. Jo, atëherë kemi hunger krejt bashkë aty.

Anita Susuri: A iu kujtohet edhe ndonjë detaj prej qytetit të Janjevës, kur keni qenë në atë kohë para se me shku në Francë?

Memedali Gradina: Po kqyre, detaje ka shumë. Sikur përpara, për shembull këtu Janjeva ka pasë tri-katër kerre që kanë pasë që me nisë... unë e di, i kom pasë tetë vjet kur e kom pre këtë gisht, tri a katër kerre a ka pasë Janjeva, a jo. Edhe pse kanë pasë pasuni të madhe, po kerre s’ka pasë. Janjeva gjithë u konë e qetësime, Janjeva kurrë s’ka pasë problem.

Janjeva si Janjeva, me pasë nejtë ata kroatë që janë dalë prej Janjevës, qatëherë e thirrshim Parisi i Vogël, po tash e kishim thirrë Parisi i Madh. Ama nejsë, Komuna e Lipjanit gjithë u kanë si fukara e sot atë ditë u mbetë. Edhe për kohë shkive edhe sot njejtë është qashtu.

Anita Susuri: A iu kujtohet kur ka qenë ndërtesa e komunës? Kur ka qenë komuna këtu në Janjevë?

Memedali Gradina: Po kqyre, qatëherë veç une jom dalë në Francë. Kur kanë nisë une veç jom dalë në Francë. Tana s’jom kanë hiç këtu, njo katër-pesë vjet s’jom kanë sebeb ushtrijes, se m’lypshin për ushtar me shku. Une, drejt me iu thanë, për qata iksha pak. Sebeb ushtrijes s’jom ardhë. Po qatëherë veç kur visha në pushim mas shtatë vjet, qashtu diçka, kur visha në pushim e kom pa që Janjeva e ka, e ka pasë ni ndryshim të madh. Se romët, minoriteti, ata punojshin, ama nuk punojshin nëpër pazare, për shembull me shitë për veti. Po masi janë dalë ata, tana kanë fillu me tregti romët.

Anita Susuri: Domethanë, në atë kohë, ma herët, para se me shku në Francë këtu ka qenë edhe... te mahalla e juq e romëve, m’duket ka qenë biblioteka, a ju kujtohet kjo?

Memedali Gradina: Po, po. Ka pasë ni bioskop, që po thojmë, atje poshtë ku është posta. Bon vaki e keni pa ku është posta? E para postës që është ai vendi i madh aty... nejsë tash u ra krejt, s’ka kurgjo

aty, ka pasë aty, edhe biblioteka ka pasë aty. E di bibliotekë ka pasë, une bile shkojsha aty në bibliotekë, merrsha do libra me lexu normal. Ka pasë bibliotekë, ka pasë, e qata romë që keni pa aty që po jetojnë, ata po jetojnë aty prej kohës... biblioteka u kanë naltë ata poshtë jetojshin aty, edhe janë mbetë aty qashtu.

Anita Susuri: E qysh kanë shku ata me jetu aty? A ju ka dhanë dikush a?

Memedali Gradina: Shteti po më duket ka liru me jetu aty.

Anita Susuri: Aty është një hapësirë e madhe më duket...

Memedali Gradina: E qajo hapësirë e madhe u kanë bioskop aty, kino, qysh me thanë, kino u kanë aty.

Anita Susuri: A keni shku ju najhere?

Memedali Gradina: Po, qysh jo. Atëherë na s'kena pasë televizor. Une e mbaj në mend, kqyre tash me kthy mrapa, babgjyshi jem në '72-tën e paska ble ni televizor "ambasador". E qatëherë na veç e kena maru këtë shtëpi. E qitshim televizorin në prezore atje, e në oborr aty u ulshim na të mahallës e kqyrshim filma. Nejse, atëherë, domethanë kur jom kanë edhe ma i vogël para se me ble televizorin, normal kena pasë dy-tre televizora komplet prej minoriteteve. Dy-tre televizora i kena pasë.

Shkojshim kqyrshim filma, u kanë niherë në javë që i bijshin prej Lipjanit. I bijshin me na lshu filma qashtu, normal me pagesë. Kinot sikur në Prishtinë. Tash në Prishtinë, sot atë ditë ka kino me siguri, po nejse nashta pak ka ra edhe anena {kullet}, se tash ka televizi e ka tulifarë programa.

Anita Susuri: A iu kujtohet çfarë filma keni kqyrë? A keni ndonjë kujtim? A keni shku me shoqni a?

Memedali Gradina: Po, po me shoqni, me shoqni gjithqysh, se shembull une kom pasë pare për tri vetë me pagu biletën, që kush s'ka pasë... dikush ka pasë gjysë dikush jo, na i mledhshim ato i bojshim krejt nimdhetë, a dymdhetë sa jemi konë krejt shoktë e mledhshim paret, tubojshim. Pa marrë parasysh, a kom pasë une ma shumë, a ai ma pak e blejshim biletën e kqyrshim filma me kauboja, indian, përpara qato ka pasë, edhe do filma të Indies. Atëherë qato filma ka pasë ma së shumti. E tana mas ni kohe t'gjatë, domethanë '75-'76, qaty dikun tana kanë fillu edhe këta filmat e Turkies, që i thojshin Karamurat ata. Se e mbaj në mend se i kqyrshim ata filmat e Turkies, karate ata të Kinës e do sene qashtu, ata filmat.

Anita Susuri: Te ajo pjesa, platoja e kinemasë a janë mbajtë aty edhe do festa, dasma?

Memedali Gradina: Po, po, po. Kohën e mramë kur s'vishin ma me lshu filmat, tana ma u mbetë ajo salla qashtu, shpraztë. Pa ulëse, pa kurgjo. E tana aty, nejse shumica na, romët, i bojshim do dasma aty se...

Anita Susuri: Ka pasë vend.

Memedali Gradina: Ka pasë vend edhe u kanë pa pare. Me ndreqë me qit' do karrika, do tavolina, ulëset qaty. Po e mbaj në mend, u kanë mirë në atë kohë edhe aty i majshin do dasma edhe dasmat mirë edhe ma hjeshëm u kanë se tash që i majnë nëpër restaurante. Se kqyre, une kur e kom martu djaln para nja dhetë vjet, po s'ka pasë nafakë me jetu me qata, e kom bo me nifarë restoranti dasmën. A besoni, kurfarë hijeshie s'ka pasë a qaty...

Anita Susuri: Qysh janë maru për shembull dasmat?

Memedali Gradina: Dasmat u marojshin, krejt çka duhet me hangër krejt nëpër shpija e bojshim. S'ka pasë nëpër restorant me shku me porosinë. Dy-tri gra në tenxhere të mdhaja e zijshin hajën e bojshin.

Anita Susuri: A ka pasë, për shembull kur keni bo festat edhe kroatë që kanë ardhë me shqiptarë?

Memedali Gradina: Gjithë. Kurrë s'ka pasë shansë ni dasëm me kapërcy pa kroatë, pa shqiptarë, pa turkë, jo.

Anita Susuri: A ka qenë gjithmonë mahalla rome kjo këtu, domethanë te posta? A ka edhe dikund mrena Janjevës që jetojnë familje rome?

Memedali Gradina: Mrena Janjevës, tash për tash, është veç një rom atje në qendër. E ka ble qat' shtëpi mas luftës prej një kroati edhe është një ashkali, po nejtse edhe ai rom. Ni ashkali është ni rrugë që shkohet përtej qanena edhe ai është atje, po kështu jena konë ngjitë në qit' pjesë që p'e shihni, gjithë qitu jemi konë.

Anita Susuri: A ka pasë Janjeva të ndame mahallat ku kush ka jetu?

Memedali Gradina: Po kqyre, do janë kanë ngjit edhe e thirrshim qashtu, mahalla e romve, mahalla e turkëve anenaj...

Anita Susuri: Përtej lumit anena?

Memedali Gradina: Po prej lumit e anena, mahalla e turkve prej lumit e anena. Tani, kroatët janë kanë shumica nëpër qendër e sene, shqiptartë anej naltë e qashtu, shqiptartë edhe ma poshtë. Gjithmonë u kanë ajo mahalla e romëve, turkëve, latinëve, kroatëve, ngjitë u kanë.

Anita Susuri: E juve, a ma shumë iu ka lidhë kultura, shembull turke ka ndiku, a kroate a qysh i keni marrë ato zakonet, traditat?

Memedali Gradina: Po kqyre, na e kemi marrë ma shumë traditën prej kroatëve se ma shumë me ata kemi pasë edhe puntë edhe shoqni edhe krejt ma shumë me ata, për qita. Ama çka me bo, qashtu u kanë koha përpara edhe tash, shembull shumica nuk dijnë shqipen me e fol.

Anita Susuri: Kroat a?

Memedali Gradina: Jo, jo, rom. Romët shumica nuk dijnë shqipen me e fol. Pse? Se s'kanë pasë bash qikaq kontakt me ata sikur me kroatë që kanë pasë, se te kroatët punojshin me ata bojshin shoqni, punojshin te ata edhe shoqni. Shembull, ai kroati ka dy-tre fëmijë, këta po bohen shokë me ata. Ajo qysh thojshin, ku është parja shkon (qeshë). Qajo është... ama apet na kena jetu bashkë pa marrë parasysh.

Nejse kroatët janë kanë ma t'fortë me pasuni e sene, ama na jetojshim bashkë, pa marrë parasysh. Shembull, kur ka pasë naj festë a naj sen, s'ka pasë shansë mos me thirrë shqiptarë e turkë e kroatë, shansë s'ka pasë. Për shembull, nejse, qatëherë u kanë video me iu tregu kur jom kthy prej Francës me martu vëllaun...

[Rrëfimi vazhdon në pjesën e dytë]

Pjesa e Dytë

Memedali Gradina: Kur e kom martu vëllaun, qajo soba u kanë e vogël aty që e kom ditë që ka me pasë dikun ka 550 mysafirë. Tana te shkolla e vjetër naltë, s'di a jeni kanë a e keni pa qata shkollën e vjetër, oborrin e shkollës t'vjetër? Kom pasë aty dy shatora kah 30 metra gjatësinë, 520 vetë i kom pasë aty. Aty u kanë dasma internacional, domethanë...

Anita Susuri: Në cilin vit u kanë?

Memedali Gradina: '90 e... kom harru edhe vjet, '92-ën qashtu diçka duhet me kanë ajo, '92-'93 qaty dikun.

Anita Susuri: Domethanë, në vende publike me bo festa e dasma nuk ia ka ndalu askush?

Memedali Gradina: Jo, jo s'ka pasë shansë me ndalu kërkush. Ja me ardhë dikush, kqyre na, ju bon vaki pak e hiç e dini, dasma te na s'u kanë ni ditë po u kanë ni javë ditë. Përgaditje e sene, domethanë ni javë ditë përpara e kem pasë muzikën nonstop prej sabahit deri në akshom. Kurrë s'janë ardhë kojshi me u anku, ja me thanë... vishin normal, vishin me bo përhapër, me pytë, a po vynë ndihma, me ndihmu. A kështu me ardhë me bërtitë, ja me ndalu, kurrë s'kena pasë atë problem.

Anita Susuri: Dashta me iu vetë edhe në atë kohë ma herët, qysh kanë qenë veshjet e juja? A kanë shpërnda si me kroat a qysh janë vesh gratë?

Memedali Gradina: Jo, kroatët e kanë pasë ni kulturë tjetër. Kroatët e kanë pasë ni veshje tjetër, diçka ma ekstra e kanë pasë ata. Me ato dimija, diqysh t'marume me dorë ato poqat ato senet. A te na

edhe te shqiptartë njëjtë janë kanë ato dimijat, do me mantilla përpara, sikur përpara që janë kanë... tash, shembull me shamia që janë edhe përpara janë kanë do mantilla, do shamia, do... ama, dimija janë kanë edhe ato jeleka me ari, përpara e di e mbaj në mend. Unë i thirrsha samarë, njojtë u kanë edhe për shqiptartë edhe për magjuptë, s'ka pasë kurfarë diference. A kroatë po, kroatët e kanë pasë ni veshje diçka ma ndryshe.

Anita Susuri: Ju e keni këtu afër mahallës ni lumë, a ka qenë ai gjithë ma i shterrun a qysh ka qenë a?

Memedali Gradina: Përpara ai lumi u kanë i paqtë, bon vaki ma paqtë se bunarët qitash që janë. Une si i vogël e di që e marojshim aty ni si zid, u mledhke uji aty e bojshim si bazent edhe u lajshim aty. Se na përparra s'kena pasë bazena sikur tash që ka, "Hajde po shkojna në bazent". Po, bazeni jonë u kanë ai lumi. S'ka pasë kanalizim aty, po tana ma vonë, dikun ka '80-ës bon vaki ose ma vonë, po prej '80-ës ma merr mendja, tash nja dy vjet përpara ja përmas, '78-ës a qaty dikun, ka nisë tana me shti edhe kanalizimat e sene e qashtu. E kanë flliq lumin, ajo është gjyna. Gjyna i madh është ajo.

Kqyre tash une jom naltë, nejse këtu e kom zor shembull veç për ujë edhe për qata dru. Me pasë rrugën, për shembull me ardhë me traktori ose me kerr me ardhë... se atje poshtë s'mundesh me nejtë pesë dakika aty. E une po iu thom atyne që po ankohen, "A jom ardhë une prej naltë me ta bo qitu a? Ti vet e ke bo. Vet bërlllogun p'e gjun në rekë. Pse p'e gjun kur pesë euro është muji". Kanta e bërlllogut mushet, vjen me kamion, çoje poshtë. Po qashtu janë mësu, vet vetit po i bojnë bërlllog tani ka faj komuna. Çfarti, komuna s'ka faj kurgjo!

Anita Susuri: Ju po thuni që prej qatij lumit...

Memedali Gradina: '78-ës qashtu kanë fillu...

Anita Susuri: Pse kanalizimin tani? A ka pasë ndonjë problem që u derdhë aty kanalizimi, a osht' faji i njerëzve?

Memedali Gradina: Normal ka pasë problem që ato kanë nisë me derdhë kanalizimin. Shpija atëherë ka pasë ma shumë, goxha ma shumë se tasht. Problem, se kanalizimi derdhet aty ujë s'ka boll, s'mun me çu. Edhe këta e kanë mush bërlllog, sikur që e keni pa, e kanë mush me bërlllog. Uji ka pak, ka pak shterret. Po shterret bunari se s'ka ujë se s'ka pasë, shembull, as borë as shi, qashtu, ka pak, ka pak klima ndryshon. E tu ndryshu klima lumi u nisë me u terë e problem është. Kanë nisë me ndreqë diçka, por janë nalë atje, kanë ndërpre poshtë dikun e këtu apet qashtu ka me mbetë po më doket. Ishalla e ndreqin po...

Anita Susuri: Edhe aty përmbi është ni mahalla Saraji, është edhe ni kullë aty. A keni kujtim për qat' pjesë?

Memedali Gradina: E di për qat' kullë edhe kush ka jetu aty edhe krejt e di për ato. Qajo kullë ka jetu ni kroat. Ai i shitke këtu pentë në qendër, e ata janë shku bajagi para luftës. Hala pa ardhë Shesheli,

ata janë shku. Ajo kulla, nejtse ata banojtshin pojthtë, naltë s'ma merr mendja që ka pahtë diçka, veç qajo kulla e di edhe kush ka banu aty.

Anita Susuri: Cilat familje janë kanë?

Memedali Gradina: U kanë ni familje na e thirrshim Pashka. Pashka ka pahtë ai emrin. Djemtë e tina janë dalë, nejtse ai ka ndrru jetën aty. Ka mbetë vet me shoqën. Ma së pari, ai ka ndrru jetën tani shoqja e tina ka ndrru jetën edhe u mbetë shpraztë ajo. E tani ni kohë mas luftës po më doket ni familje shqiptare u hi me banu se s'kanë pahtë ku me banu. Janë hi ata kanë banu brenda edhe tash osht' shpraztë po më doket, s'osht' kërkush aty.

Anita Susuri: E çka u bo ajo familja shqiptare? E ka liru vendin a qysh?

Memedali Gradina: Po, po, e ka liru vendin. U shku ajo, kurgjo veç në atë moment... ju e dini që koha e ka bo të vetën. Dikond e ka dëmtu e ka bo katastrofë veç jo e kanë banu aty pak edhe e kanë lëshu kanë dalë.

Anita Susuri: E ajo familja kroate që thatë, qysh ata kanë pahtë kullë? Se krejt kanë pahtë shpija zakonisht. E qysh u bo që ata kanë pahtë kullë?

Memedali Gradina: E qysh u bo tasht, ajo u bo bajagi para se une me u lindë u bo. Qysh u bo nuk e di, veç e mbaj në mend kush ka jetu e qysh, po ato. Ama qysh u bo ajo nuk e mbaj në mend.

Anita Susuri: Domethanë, ata janë marrë me tregti të pemëve?

Memedali Gradina: Po, po. Ai u kanë, këtu në Janjevë u kanë rojtar për ku ka rrush ato, se përpara Janjeva ka pahtë goxha rrush nëpër Janjevë e ai rujke rrushin mos me vjedhë dikush. Normal, fëmija hijshin edhe e merrshin kah ni grushtë, ai rujke si rojtar. E mbaj në mend një pushkë e ka pahtë ni llovaçkë [armë për gjah] edhe djemtë e atina shitshin pemë këtu në qendër të Janjevës.

Anita Susuri: Këtu është, po më doket vreshtari që ka qenë Gradina a qysh e ka pahtë, Glama a qysh e ka pahtë emrin ajo kodra vreshta që ka pahtë, rrush?

Memedali Gradina: Glama osht' knena, a Gradina, mbiemri jem është Gradina. Osht' te ambullata e vjetër pojthtë ku është mullini në qoftëse e keni pa ku është e përballë mullinit, aty ka pahtë vreshtat që ka pahtë rrush e sene...

Anita Susuri: A ju kujtohet Janjeva sa i përket gjelbrimit, se thojnë që shumë ka pahtë pemë, vreshta?

Memedali Gradina: Aty kur vijke sezona shembull, muji gusht, ka pahtë secili ato magarët, koshat nëpër ata magarët. Shkojtshim i merrshim do punëtorë, se vet s'ka shansë me mledhë. I merrshim do punëtorë e shkojtshim me mledhë rrush. Nonstop naltë e pojthtë me magarë, edhe ata e mbajë në

mend. Se rrush ka pasë, këtu në Janjevë për krejt Kosovën ka pasë. Po tash, ka pak, ka pak, kërkush s'po prashitë e u hupë.

Anita Susuri: Ju thatë që vetëm disa klasë i keni kry, tani keni vazhdu në Francë...

Memedali Gradina: Po, në Francë e kom vazhdu.

Anita Susuri: A muni me na tregu qat' periudhën? Qysh u bo që me shku ju atje?

Memedali Gradina: Po ma së pari, '73-ën u shku baba, se ka pa që këtu s'ka pasë punë. U shku ai, tani na jena mbetë me nanën pesë fëmi. Normal, për qato kur më keni pytë a e dini nana qysh marojke mishin e këto, bash qatëherë jena kanë kërkund hiç, kriza. E qat' kohë, bile e maj në mend shumë ma mirë se krejt tjerat. Shkojsha qashtu e merrsha ni copë suxhuk e ku pjeke nana aty, ku punojke, edhe ni copë bukë te shpija edhe me hangër.

Për shkollë, e mbaj në mend, nejse aty deri në të katërten klasë jom kanë. Po shkolla përpara u kanë tjetër. Tjetër respekt kanë pasë edhe mësustë edhe... s'di shkolla përpara u kanë përnime që mujshim me thonë shkollë e tasht...

Anita Susuri: E kur keni udhëtu për Francë, a ka qenë... për Paris m'doket keni shku apo cilin vend?

Memedali Gradina: Në Lyon.

Anita Susuri: A ka qenë hera e parë që keni udhëtu jashtë Janjevës, a keni udhëtu edhe ma herët?

Memedali Gradina: Jo, jo, të parën here jom shku atje tana '75-tën. Baba ka marrë motrën edhe ni vëlla, e '77-ën tani jom shku une edhe ni vëlla. Se krejt ka pak, ka pak na ka marrë. Vike baba me kerr, tana prej Francës vike në pushim nja nji muj ditë edhe qashtu jemi shku. Në të parën herë, jo që jom kanë dikun edhe... po parën herë që jom dalë prej Janjevës... nejse deri në Lipjan e Prishtinë jom kanë, ama jashtë Kosovës t'parën herë qatëherë jom kanë që jom dalë prej France.

Anita Susuri: Qysh e keni përjetu ata? Qysh iu ka dokë ai vend në krahasim me ku keni jetu?

Memedali Gradina: Kur jom shku në Francë, atje une kom nisë me kajtë për me u kthy mrapa. S'kom mujtë me qëndru njo dhjetë ditë, nonstop u përlejsha me rahmetlijen, me plakin, "Kthejem ku m'ke marrë, kthejem në Kosovë, në Janjevë".

Anita Susuri: E pse?

Memedali Gradina: S'kom pasë shoqni, s'kom pasë... jeta krejt ndryshe, ndërtesa të mdhaja ato, une s'kom pa. Nejse tana mas njo dy jave kom nisë me shku në shkollë. E i thojsha vetit, "Ja mëso gjuhën, ja je mbetë për kërkund". E pa qare kom pasë me mësu gjuhën, se mashallah gjuha m'ka shku mirë. E kom mësu gjuhën frënge mrena gjashtë muj ditësh, qashtu diçka. E tana shkojke ma kollaj.

Anita Susuri: Me çka jeni marrë atje? Çka keni punu?

Memedali Gradina: Ma së pari kom fillu shkollë atje me mësu gjuhën, jom shku ni vjet kom mësu gjuhën frënge, tani kom fillu me shkollë. Normal, atje krejt prej fillimit, se qato klasë prej ktuhit nuk vazhdojshin atje. Krejt prej fillimit, po qysh i kom pasë pak do vjet ata më lirojshin që mujsha me kry dy klasa për ni vjet. E i nxuna ata në vjet e mia. Tana kur e kom kry tetën klasë kom nisë shkollë të mesme për me mësu për mekanik...

Anita Susuri: Domethanë, edukimin e keni përfundu nji pjesë atje apo?

Memedali Gradina: Po, po, edukimin atje. Jo nji pjesë, po pjesën ma të madhe atje e kom kry.

Anita Susuri: A ka qenë si shkollë e veçantë për ata që kanë ardhë apo si ka qenë?

Memedali Gradina: Jo, jo kështu shkollë normale me francezë me krejt ato, shkollë normale. S'ka pasë shkollë të veçantë, jo.

Anita Susuri: A keni ndonjë kujtim prej asaj që iu ka ndodhë?

Memedali Gradina: Ka shumë aty, me nisë aty është histori e madhe, se qysh me thanë rinia janë ma të mirë qatje e kom kalu une, qatje e kom kalu. Edhe qatje mandej kur e kom dhanë provimin për kerr, për leje, atje në Francë e kom marrë une lejën.

Anita Susuri: Domethanë, deri tetë vjeçaren e keni përfundu në Francë, tani qysh ka vazhdu shkollimin?

Memedali Gradina: Jo, e kom vazhdu shkollimin. Po, po e kom vazhdu, jom shku tani për zanat, me marrë zanatin automekanik. Edhe katër vjet jom shku me marrë zanatin mekanik. E tana atje rinies po mundëson Franca, jo veç Franca po krejt jashtë Europa është qashtu. Rinies po mundëson. Une veç jom shku me pytë në bankë, a po më jepin kredi me ble ni garazhe, meniherë m'kanë dhonë kreditin.

Une veç e kom gjetë ni garazhe... une s'kom pasë punë me i pagu atina, po ai u shku në bankë veç ia kom dhanë adresën ku me shku. U shku në bankë, e banka ka pagu e une ia kthejsha krejt ka pak, ka pak bankës. Se unë atje kom pasë garazhen tem, meniherë si kom dalë prej shkollës e kom ble garazhën tem e kom punu për veti.

Anita Susuri: Sa vjet keni punu?

Memedali Gradina: Tri vjet kom punu, tri vjet. Prej '82-tës deri '85-tën. '85-tën ma s'pari, tani janë kthy prindtë e mi me fëmi krejt, e une jom kthy mrapa në Francë e '86-ën jom kthy edhe une se s'kom mujtë pa prindtë, pa familjen veç une vet s'kom mujtë. Qashtu edhe une jom kthye, e kom shitë atë

garazhë atje e krejt. Kur jom ardhë këtu e kom maru qit' shtëpi për vëllaun qaty. Qato pare që i patëm i harxhitëm e qashtu.

Anita Susuri: Kur jeni kthy, domethanë, në Janjevë, çka iu ka dokë ma ndryshe? Qysh ka qenë atëherë qyteti edhe atmosfera?

Memedali Gradina: Po kqyre, qatëherë, drejt me ju kallxu kur jom kthy në '85-tën kurfarë ndryshimi s'mu ka dokë. Kur jom ardhë ndryshime të mdhaja s'ka pasë, se tamon jom kthy këtu kom nisë me punu nëpër pazare. E kom pasë ni kombi që e kom pru prej France, mas njo nji vjete e kom shitë qat' kombi e kom ble kamion.

Puna shkojke mirë, punojshim mirë edhe me vllazni, une edhe dy tjerë vllazni, vet i treti punojshim shumë bukur. Se këta latinët janë dalë, janë shku në Kroaci tana u mbetë ajo tregtia për neve. E na qashtu punojshim. Ka pasë punë, ka pasë punë përpara. Edhe fitimi, se jo veç punë po edhe fitim ka pasë. Edhe une s'kom diktur kurfarë ndryshimi aty. Çdo ditë nëpër punë, për shembull, në saba shkojsha në aksham u kthejsha e qashtu.

Anita Susuri: Dashta me iu vetë pak edhe për pjesën kur jeni martu, kur jeni njoftu me shoqen e ju. Si ka ndodhë kjo? A iu kujtohet?

Memedali Gradina: Po, qysh jo, ajo jetë për kujtim gjithë. Kur jom kthy prej Francës, domethanë '86-ën normal une e kom ditë që s'ka me u kthy ma atje në Francë. Hajde thashë me kqyrë me pasë kah me dalë e sene. S'kom pasë ndërmend me u martu, po me u njoftu me najnjo. E kom pasë ni shok, ai punojke bash në "Metallac" aty. Kusheri, se jo shok, po kusheri. Ai punojke në atë firmë aty në "Metallac" edhe ajo punojke, gruja jeme, përpara punojke në "Metallac" në qat' firmë. Ajo është prej ni katuni, Gushtericë, s'e di a p'e dini Gushterica ku osht'?

Ai m'thirri, tha, "E di une çfarë karakteri ki, une e kom aty njo të njofshme që punon te na shumë e mirë është, e aftë, e shkollune si ti..." Ajo ka fakultet, shoqja jeme, e ka kry fakultetin ajo. Thashë, "Me pasë fakultet ajo kish hi në tjetër punë, jo aty në 'Metallac'", "Po, jo s'ka mujtë me gjetë punë". Edhe me të vërtetë qashtu u kanë. "Hajde" thashë, "me u njoftu me ata".

Jom njoftu me ata, hajt ni ditë, dytën, tretën ditë, qashtu kadal kadal, mas njo gjashtë muj dite i kom çu këta t'mitë me lypë. Baba asaj i ka dekë bajagi moti, u mbetë veç ajo me nanë edhe me ni motër bajagi të vogël, 14 vjet i kanë në mes veti. Kur ajo m'tha, "Une po, po vi. Po me ditë, nana jeme edhe motra jeme kanë me t'mbetë ty në dorë se s'ka kush i kqyrë".

E qatëherë si ju tregova me tregti punojsha mu s'më interesojke rroga e asaj. Une i thojsha, "Qat' rrogë që po merr jepja, mu s'më vyn rroga jote", "Ama mos me ma ndërpre punën", "Pse me ta ndërpre punën, ti vazhdo punën tane". Edhe qashtu jom njoftu me ata, janë shku këta me lypë. Unë i thashë, "Dasëm me maru s'kom qef, jo që s'kom pare po dasma si dasma është budallaki për mu, veç harxhit pare. Në qoftëse don hajde shkojmë dikun nja dhjetë ditë në pushim e pushojmë". "Jo vi, jo s'vi". Edhe qashtu u bo erdh e qashtu...

Anita Susuri: Çka ka punu bashkëshortja e juv në “Metallac”?

Memedali Gradina: Ajo ka punu me ata, s’di bash qysh me iu tregu, me mising me qit misingin me provu aty, nifarë kiselinë është aty, me provu, ajo e marojke qat’ kiselinën. Si laborator, qysh me thanë, laborante u kanë ajo.

Anita Susuri: Çfarë fakulteti ajo ka përfundu?

Memedali Gradina: Ajo ka përfundu për laborante. Ajo e ka kry mirë, po ne jse s’ka mujtë me gjetë punën. Ajo normal është sikur çika jeme tash... e kom ni djalë edhe ni çikë. Djali e ka kry për veterinar, ai ne jse edhe për kështu punë s’ka, ama çika e ka kry medicinën para shtatë vjet. E ka pa që s’ka punë ma kërkund me gjetë edhe u martu para shtatë vjete ngat Brezovicës atje. S’e di a e dini, në Shtërpcë atje.

Ajte u martu i ka dy fmi, ni djal edhe ni çikë e sot e atë ditë pa punë. Kur kom pytë këtu me punësu qatëherë rahmetlija, plaki jem, u kanë përfaqësues i romëve, se ai u kanë përfaqësues i romëve 30 e kusur vjet. E ka pytë këtu qatëherë u kanë nifarë Shukri Buja kryetar i komunës në Lipjan i tha, “Po, po”. Kur e kena pa na u ardhë ni serbe me punu qaty në vend të asaj.

S’ka mujtë me punu. Drejt me iu thanë tani jom shku në Gushtericë me pytë te këta serbët... çdokund veç me pasë ni punë çika se e ka kry shkollën pa punë. Po ata m’lypshin do pare une thashë, “Me pasë qikaq pare s’e kisha punësu hiç”. Po çka me bo, qashtu, s’i kena pasë dajtë e tezakët fort e ka mbetë pa punë. Tani, çika u martu qashtu badihava e ka kry shkollën, veç u mundu katër vjet që u kanë në shkollë të mesme. Dimrit s’ka pasë autobusa ajo në kamë te poshtë e... po çka me bo jeta u ardhë, tash duhet me thanë elhamdulillah me qato që kemi.

Anita Susuri: E në atë kohën kur jeni kthy çka ka ndryshu te atmosfera, te njerëzit? A ka ndryshu diçka?

Memedali Gradina: Jo, qatëherë ndryshime të forta s’ka pasë, hala u kanë atmosfera si para se me shku në Francë, domethanë qatëherë hala u kanë deri dikun. Veç, pas luftës domethanë, njerëzit që jom rrit me ata s’di ku janë. Se muj me ju thanë... kqyrne tash, përpara qysh u kanë, përpara une e di babgjyshi jem, që banojshim që ju tregova që 27 anëtarë jemi kanë dy dhoma kemi pasë. Kom edhe ni shtëpi poshtë atje. Përpara kur vishin do mysafirë të hujve këtu domethanë, normal minoritet i romëve, babgjyshi jem dilke në rrugë i merrke ata mysafirë i kthejke te na ma s’pari me hangër bukë, me pi ka ni kafe e tana ai bashkë me gjithë ata shkojke me mysafirë te kojshia.

A tash mysafiri i jonë po na vjen para dere, na p’e çelim herën, he çka po don? Kqyre çfarë kohe u ardhë. A përpara, subhanallah, përpara u kanë... qe këtu Janjeva edhe qata 39 shtëpi që jem kërkush as nuk vjen as me shku te dikush as kurgjo. Kur po zatetim në rrugë dikun ose në qendër, qysh je si je, qe çfarë kohe u ardhë tash. Nuk e di pse ky ndryshim apo qashtu.

Anita Susuri: Aty brenda çarshisë është edhe xhamia, a keni kujtim prej xhamisë diçka që iu ka lonë përshtypje?

Memedali Gradina: Kqyre, xhamia përpara une e di qysh u kanë, nejtash e kanë ndreqë xhamien po përpara drejt me iu thonë nuk shkojsha në xhami, po qito vitet e mrama jom me pesë vakte namaz. E përpara nuk shkojsha në xhami po imamin e njofsha mirë edhe shumë mirë, rahmetlijen Mulla Irfanin. Ai u kanë me plakun tem shokë, vijke, shok i shpijës jo veç qashtu.

Ai vijke, rahmetlija, te na plaki jem shkojke te ai. Mulla Irfanin edhe, domethanë hoxha jonë, Mulla Irfani, edhe ky prifti, [Don Matej](#), prifti i katolikëve ata e kanë majtë Janjevën qashtu me kanë, vllaznimi-bashkimi. Ata dy vetë, se mos me kanë ata dy... tani ma mas luftës sikur do vena që romët e kanë kallë e kanë bo... nejtash na këtu kurgjo kërkujna s'i kena bo edhe për qata sot e asaj dite jena këtu. Se ajo u ni, për krejt Kosovën u ni që na të Janjevës s'e kena bo... veç që kena ndihmu për kohë të luftës.

Këtu në Janjevë na veç që kena ndihmu vllaznive shqiptarëve se ata s'guxojshin me dalë na apet deri dikun dalshum me naj sheqer, me naj sen, me naj çaj, me naj keks për fëmi. Ama, mas luftës ai prifti i ktyne katolikëve, edhe ai Mulla Irfani, hoxha jonë, e ka qetësu punën që Janjeva... edhe për qata, ju kqyrni, ecni nëpër Janjevë kërkund asni shtëpi jo kallë a diçka, jo, jo, jo. Nejtash, që janë ra prej vetëvetit ajo tjetër është se kur s'ka njerëz t'u banu në qat' shtëpi, normal ni qeremide thehet nis me pikë, pikë kah pak kah pak ajo shtëpia...

Anita Susuri: Masi i përmendët shtëpijat, a ju kujtohet qysh kanë qenë atëherë kur kanë qenë të mirëmbajtuna ato shtëpia? Që s'kanë qenë të rrënume jeni kanë ma të ri, ma fëmi. A keni shku te ata? A ju kujtohen ato shtëpia?

Memedali Gradina: Po kqyre, ma së pari janë nisë, tash, për shembull kur jena kthy na prej Francës që thojsha une që atmosfera nuk kish ndrru shumë. '87-ën e kena nisë me maru qit' shtëpi që është qitu, qikjo është shtëpia jeme edhe qajo është shtëpia jeme. Po nejtash, e jemja, për vëllaun e kom nisë me maru qata.

Materialin, sikur që e dini, me pru naltë kamioni s'vjen, as kerri s'vjen naltë. Qajo ka vyjtën me bajtë krejt me dorë, domethanë, me zall, me ciment, me qeramide, me krejt ato. Krejt në dorë, po qashtu janë kanë përpara. Tamon vijke materiali atje poshtë, tamon u shprazke materiali u mledhshin 20-30 persona ai pak, ai pak, ai pak mrena ni ore materiali vijke naltë.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Shtëpiat e kroatëve, për shembull, kanë qenë ma të veçanta? Qysh ju kujtohen juve?

Memedali Gradina: Qysh t'veçanta?

Anita Susuri: Shembull prej pamjes, kanë qenë dy katëshe, ni katëshe a kanë pasë ndonjë ndryshim me shtëpiat e shqiptarëve?

Memedali Gradina: Jo, jo, ndryshim s'ka pasë. Nejse, për jashtë jo. Për jashtë, shtëpiat si shtëpia qashtu qysh janë sot edhe qatëherë janë kanë. Nejse, për mrena bon vaki ka pasë ndonjë ndryshim. Tash s'jom kanë nëpër krejt shtëpijat, ama normal qato pak ku jom kanë ndryshim ka pasë. Sikur, shembull ndryshim prej neve që banojshim 27 vetë në dy dhomë, ata normal e kanë pasë hapësirën ma të madhe e mobilet ma të mira, ma të reja. Po neve... kur u prishën te ata japshin neve, "A po doni me marrë, mos me gjujtë?" Qashtu u kanë. Nejse, sot e atë ditë... edhe te na shembull, m'u ka prishë kjo hajde mos me gjujtë, "A po vjen bre me marrë se p'e blej ni tjetër".

Anita Susuri: Ata kanë pasë familje të mdhaja, kanë pasë shumë fëmi.

Memedali Gradina: Ata thojshin, "Fëmi edhe pare s'janë kurrë boll". Domethanë, ni familje ka dymdhetë-tremdhetë fëmi i ka pasë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë si fëmi me jetu në qat' atmosferë me plot shoqni, me plot fëmi?

Memedali Gradina: Po kqyre, ajo dihet, sikur dasma shembull kur janë pesë vetë e kur janë 50, normal atmosfera është ma e mirë. Normal, qashtu sa ma kallaballak edhe sa ma mirë osht'. Qetash me u kthy apert mrapsht... përpara jemi kanë 27 anëtarë atje jetojshim. Une si fëmi qatëhere e mbaj në mend gjyshja jeme, rahmet i pastë shpirti, kur e shtrojke ni çarçaf të... se çfarë tavolina, as sofër s'kena pasë po ni çarçaf te poshtë edhe na si ushtria. Kështu, dy-tre vena se s'ka pasë secili tanjirin për veti. Na si ushtarë dhetë lugë me ni tanjir, edhe buka u hajke. Qe qitash vet i katër ti te shpija, a besoni zoti 25 killa mill nuk i mbaj në mend kur i kom ble. A shoqja, po gatun gjithë se shoqja s'po don bukë prej furres nuk p'e han, 25 killa mill, kom harru kur i kom ble.

Anita Susuri: Në atë kohën domethanë, që jeni kthy edhe që thatë që nuk ka pasë atëherë shumë ndryshime. Kur e keni vërtetë që po bohet ndryshimi te popullsia, te atmosfera?

Memedali Gradina: Te popullsia mas luftës. Kqyre, deri në '95-ën-'96-tën edhe para luftës veç ka nisë populli diqysh si bajatshëm. Tregtia ka nisë me ra, gjinja janë nisë me dalë. Tash, nuk e di a kanë vërtetë, a kanë ditë që ka me u bo diçka, ni Allah e din. Veç prej '95, '96 qaty veç u nisë me u kanë bajat e ma bajat. E nejse tani '99-tën kur ka kërset lufta qatëherë kanë nisë... kroatë ma, kroatë s'ka pasë asnjo në Janjevë.

Në kohën e bombardimeve, asnjo s'ka pasë, ata janë dalë meniherë, janë shku në Kroaci krejt i kanë mshel shtëpitë. Janë mbetë ni familje, po më doket, ai që e majke kafën, një djalë i ri ai u mbetë me shoqen. E këta romët, edhe këta normal prej tutës, tu i ni bombat anena, bombat knena... qe bile këtu une e kom pasë ni lluster tjetër, qita frik e kom ndreqë qitu se u kanë si te poshtë ai llusteri, tjetër u kanë.

Bomba në Graçanicë u ra, këtu llusteri në tokë u ra. E normal, fëmijtë i kom pasë të vogël ata janë kanë aty në koridor veç kanë ni që u këputë edhe këtu diçka. E normal ata fëmi të vogël janë trishtu prej tutës. E ai vëllau tha, “Valla une s’ muj me i lanë fëmijtë qashtu” tha, “une ka me dalë masi po shkojnë këta romët tjerë”. “Përhajër rruga, qe paret”. Pare kena pasë qatëherë pak që punojshim, “Bujrum pare, sa t’vyn?” Qikaq, “Qe”.

Ai u shku, tani edhe i dyti vëlla, “Edhe une po shkoj se kqyri fëmijtë”, “Ani,” thashë, “S’o puna e fëmive, po puna e grujës” se te na thojnë, ku knon pula pak shtirë osht’ (qeshë). Më falni që po thom qashtu. Edhe ai ka deshtë me shku, nejse, edhe ai është shku. Plaki jem, rahmetlija, m’ka lutë edhe mu, m’tha, “Ngo knena, shko se këtu mos prit që bohet mirë”, “Jo bre, ti plaki jem nuk din kurgjo se këtu ka me u bo ma mirë se Amerika”, “Qysh bre une gati 70 vjet nuk po di ma mirë, e ti po din ma mirë se une”, “Hajt, ki me pa,” thashë, “këtu bohet ma mirë se Amerika”.

Edhe qashtu krejt me iu kallxu, une me qat’ mend që këtu bohet mirë. Nejse, prej tutës s’kom pasë çka me u tutë une kurgjo kërkujt keq s’i kom bo. Po, prit që bohet mirë, qato pak pare që i kom pasë edhe ato janë shku. Se parja hazër nuk rrin aty, nonstop nxerr, nxerr, ato janë shku. E pa qare e kom pasë tani me hi te ni kroat me punu. Edhe une tani kom punu si plaki jem te maqinat aty, te prodhimi, shtipalka... qaty kom punu njo ni vit aty, tani jom dalë si shofer e shkepsha do mall nëpër Kosovë.

Anita Susuri: E kur jeni kthy prej Francës, a keni vazhdu me profesionin e juj a keni fillu...

Memedali Gradina: Jo, jo, tregti. Jo, profesionin e kom lanë krejt se e kom pa që tregtia u kanë shumë ma i mirë se profesioni jem, tregtia ka pasë pare mirë.

Anita Susuri: Qysh ka shku tani ajo? A keni ble mallin, a e keni...

Memedali Gradina: Po, po, e kemi ble mallin. Këtu janë kanë tri magazina t’mdhaja që jepshin mallin me shumicë, kroatët normal. Kroatët bishin mall prej Kinës e sene, ata bijshin mall. Blejshin me shumicë, na e blejshim prej tyne edhe e shitshim në pazar.

Anita Susuri: E ni kohë, domethanë, kroatët e kanë përpunu vet plastikën e metalin tani kanë fillu...

Memedali Gradina: Tani kanë fillu prej jashtit... po ma lirë u kanë me pru prej jashtit se ata vet. Sikur prej mas luftës, për shembull ma këtu në Kosovë rrallë dikush që ka mujtë me... shembull, ai këtu që punojke naj kerr të vogël, lodra, atij i kushtojke 1 euro e 20 cent, ai me 20 cent e bijke prej Kinës e për qita tani u shkri prodhimi këtu.

Anita Susuri: A iu kujtohet koha, domethanë kur kanë fillu me ikë kroatët? Vitet e ‘90-ta kur ka ardhë këtu Shesheli, a iu kujtohet ajo dita?

Memedali Gradina: Po kqyre, une qatëherë jom kanë në pazar, domethanë me shitë normal s’e di tash në cilën ditë u kanë, bash saktë s’ muj me ditë. Veç kur jom kthy prej pazarit, jom shku me ble mall që për nesër me u pregadit e kom ni aty në qendër, tha, “U kanë Shesheli sot në Janjevë”. Mu m’ka

ardhë si hajgare ajo. Thashë, “Le bre, Shesheli po vjen në Janjevë. Çka lypë Shesheli në Janjevë? Edhe me bo me hi ai gjallë s’del prej ktuhit”. Bojshin be shoqnia, “More vallahi u kanë. U kanë deri naltë te kisha edhe në kamë, në kamë ka ecë”. Une nuk besojsha, “Jo, jo,” thashë, “Nuk ka chansë”. Kur veç janë nisë... ata i thirrshin për me shku, sikur une vet që kom ikë prej ushtriye edhe ata kanë nisë me thirrë ushtarë me shku edhe këta për mos me shku ushtarë shkojshin në Kroaci. Rinia u ikë.

E normal baba e nana te shpija çka bon pa fëmi? Edhe ata kanë nisë me shku e janë mbetë edhe ata. Ata s’ma merr menja që janë dhetë familje këtu në Janjevë, dhetë-pesëmdhetë familje bon vaki janë metë, a shumica janë kanë ata këtu në Janjevë. Po për ata bash Shesheli e ka bo që Janjeva u shprazë. Ata qatëhere e di, me pa s’e kom pa ama me t’nime kom ni qashtu që u kanë këtu e ka lanë do fjalë bajagi keq po m’doket. Se s’kom ni, me veshtë e mi s’e kom ni, po kom ni që ka lanë do fjalë bajagi keq edhe ata prej tutës janë dalë.

Anita Susuri: A ju kujtohet ajo kohë kur kanë ikë ata me kamiona me u shpërngulë domethanë? A i keni parasyshë qysh ka qenë...

Memedali Gradina: Kush ka hi?

Anita Susuri: Kroatët kur kanë fillu me u shpërngulë?

Memedali Gradina: Qatëherë na i nimojshim. Vishin kamiona këtu, ata i ngarkojshin mallin e vet. Normal, ata që kanë pasë qysh me lanë këtu. Normal, që me bo nesër me dalë e marr edhe këto me veti, s’ka pare tjera me ble. Na i merrshim qashtu, shkojshim, ngarkojshim kamiona, u përshëndetshim me ata si vllavi me vllaun. Qe edhe sot e asaj dite kur po vijjnë najhere këtu në Janjevë... ata po vijjnë ktu në Janjevë kur kanë naj festë a diçka po vijjnë. Na po përçafum me ata se s’kena pasë kurrë t’keq.

Anita Susuri: E qysh bohet atmosfera kur vijjnë ata? A është ma gjallni veni?

Memedali Gradina: Ma gjallni po doket meniherë veni që është ma gjallni. Ata kur kanë naj festë, kur po vijjnë aty në qendër po doket që osht’ ma gjallni se meniherë nisin me knu, me... shoqnia tjetër edhe po pijnë kah pak ata normal. Feja jonë që nuk lejon pijen e atyne lejon.

Anita Susuri: E dashta me iu vetë edhe për xhaminë. M’u kujtu që është xhamia edhe ni objekt afër xhamisë, një si shtëpi e vjetër. Çka është ajo? A është si pjesë e xhamisë apo...

Memedali Gradina: Mrena në oborr të xhamies?

Anita Susuri: Po.

Memedali Gradina: Po, mrena në oborr të xhamies është edhe ni objekt. Aty osht’, ai objekti osht’ për gra. Gratë po falen atje edhe përmas osht’ aty për me la xhenazen në atë objekt.

Anita Susuri: A ka qenë gjithmonë aty?

Memedali Gradina: Jo, tash frik... turqit e kanë maru, Turqia ka investu aty.

Anita Susuri: Domethanë, përpara ka qenë vetëm xhamia? Nuk ka pasë aty...

Memedali Gradina: Veç xhamia... edhe nejtse, xhamia u kanë me ni objekt përpara, po ni objekt krejt tjetër si ni shtëpi e vogël. Po tana e kanë hjekë këta e kanë rregullu xhamien. Qat' objekt e kena qit' atje edhe lodra për fëmi. A keni pa aty si park që e kanë bo? Edhe aty ka pasë ni shtëpi, po xhamia e ka ble qat' tokën edhe qata e kanë hjekë po qata krejt ni firme e Turqisë e ka bo. Turkët e kanë bo ata.

Anita Susuri: Domethanë, kur është renovu xhamia është ndërtu edhe ai objekti?

Memedali Gradina: Po, po, është ndërtu edhe ai objekt.

Anita Susuri: Dashta me iu pytë edhe për ditën e pazarit që u bo këtu në Janjevë që ka qenë t'premtëve. Qysh ka qenë atmosfera? A keni ndonjë kujtim?

Memedali Gradina: Pazarit përpara këtu në Janjevë çka bishin e shitshin. S'ka pasë problem diçka me u kthy mrap. Se këtu në Janjevë, une si iu thashë edhe apet po iu thom, u konë Parisi i Vogël. Pasunien e kanë pasë kroatët, nejtse kanë pasë edhe shqiptarëve do pasuri, ama si këta kroatët që janë kanë, rrallë, rrallë najkush naj kroat që u kanë dukara, ata pasanik të mdhaj janë kanë.

Edhe kur vishin, shembull këtu me shitë s'ka pasë problem për ata edhe burrat s'dilshin hiç po veç gratë me ble. Pare nëpër xhepa sa të dush e blejshin. Atmosfera, dita këtu kur u kanë pazar, qysh me thanë, si dasma u kanë. A tashti s'ka tre-katër veta nëpër pazar. Edhe ato që i bjen a i shet a s'i shet, se tash marketa kahmos i ki shkojnë gjinja blejnë nëpër marketa.

Anita Susuri: A keni ndonjë kujtim që ju ka ndodhë apo a keni dëgju diçka që ka ndodhë në pazar?

Memedali Gradina: Jo, veç qashtu që e mbaj në mend qatëhere qysh po thuni që u kanë pazarit si dasma, a jo qashtu diçka. Edhe s'më interesojke fort atëherë pazarit. Shkojke gjyshja i merrke lang, normal qatëherë na s'kena pasë pare për mish po qata lang, qato specia qaty kapak e me kry... naj pasul, normal, nëse mbetë pare për pasul.

Anita Susuri: Domethanë, masi që kanë fillu me u shpërngul kroatët, mas vitit '90-të, qysh ka qenë jeta në Janjevë? A ka ndryshu diçka?

Memedali Gradina: Po kqyre, jeta pa kroatë këtu në Janjevë u kanë e bllokume. Na e kena diktu meniherë që këtu bllokohet, se ata janë kanë tregtarë, shkojshin kamos. Domethanë, ata shkojshin prej pestit muj deri në të dhjetin muj u kthejshin, me thanë, pesë muj ata burra edhe fëmi prej 18 vjet e te naltë s'janë kanë këtu. Tonë verën ata s'janë kanë te shpija, punojshin kur vishin këtu i bijshin me paketa paret.

Anita Susuri: Thatë që gjatë luftës keni qëndru këtu në Janjevë, qysh ka qenë lufta për juve? Lufta e Kosovës.

Memedali Gradina: Lufta për mu... une ma së pari drejt me iu kallxu as s'ma merrke menja që kanë me bombardu. Thashë, "Pse me bombardu?" Po veç kur e kom ni në televizor, "Avionat janë nisë". Hala pa kry ai fjalën rryma u ndalë, e para bombë në Graçanicë u ra. Veçse u ndal rryma, une kom dalë në oborr. A besoni Zotit, po më doket dheu prej atyhit, në qeremide e kom ni dheun. Aty veç tuta, thashë, "Hajde hajl i koftë!" Po apet une me i qetësu fëmitë, çka bohet për krejt, bohet edhe për neve. S'kena çka bojna! Hinëm mrena, jena tubu krejt me ni dhomë tjetër atje. Prit që nalet, prit që nalet, ajo zi e ma zi. Edhe qashtu e kanë shprazë Kosovën, jo veç prej neve po e ka shprazë Kosovën komplet. Po nejse, tana janë nisë me u kthy.

Normal, qatëherë jom shku në Prishtinë e kom pasë gjyshen smutë, se gjyshen e kom pasë hala gjallë e babgjyshin jo. Gjyshen e kom pasë smutë, jom shku në Prishtinë me marrë do barna me ble. Nejse prej '80-ës kom pasë gjithë kerr. Kur jom shku me kerr tem atje në Prishtinë me marrë do barna, çka me pa në Prishtinë? Katastrofë. Bash jom shku deri në stacion të autobusave me kqyre. Stacioni i autobusave u kanë, qysh me thanë, s'di qysh me ju tregu çfarë kallabllaku u kanë si panair me kanë...

Anita Susuri: Tu u shpërngulë njerëzit?

Memedali Gradina: Po presin autobusa plot për me shku. S'ka pasë aty, veç romë, a veç shqiptarë, jo, jo. Aty s'u kqyrke kush osht' tek osht'. Aty veç hishin nëpër autobusa me dalë, ku shkojshin gjinja as une vet nuk e di. E tana mas ni muj bombardimi, ashtu siç ju kom tregu, ai vëllau tha, "Une ma s'muj me qindru" tha, "kjo s'e ka ndërmend me u ndalë. Une kom fëmi me u trishtu fëmija, po dal jashtë".

E tasht une me kanë sebeb me thanë, jo bre prit a diçka... "S'ka problem, qe paret". U shku në Itali prej Italisë në Gjermani. Ky i dyti vlla kur ka ni që qaq kollaj u shku në Gjermani tha, "Edhe une po shkoj se kqyre fëmija", "S'ka problem!" Thashë, "Bujrum paret edhe për ty". Edhe ai vëllau u shku une mbeta me fëmi edhe me babën e nanën këtu edhe qashtu.

Anita Susuri: E kur u shliku Kosova, a iu kujtohet ajo dita që ka përfundu lufta?

Memedali Gradina: Po, po. Kur u shliku Kosova, kur u shliku Kosova mas 60 e kusur ditë së pari jom dalë në qendër, sefte jom dalë në qendër, këtu Janjevë domethanë. Se në fillim, dilsha, visha po kur m'ka hi tuta prej ushtrijes që u kanë këtu, ma s'jom dalë se edhe s'guxojsha. Ni shoku bile ka hangër flakaresha që i kanë mbetë qato, prej një polici serb. Tani 62 ditë gati s'jom dalë hiç.

E kur kom ni që NATO u hi te na sefte, janë hi anglezët këtu. Qat' ditë shumë mirë e mbaj në mend. Jemi dalë në qendër e kemi festu me shoktë meniherë nëpër kafe... qatëherë pijsha, drejt me ju kallxu. Nejse, qe do vjet e kom nisë namazin edhe s'pe pi ma. Dulem festum, domethanë edhe qatëherë problem na s'e kena pasë. Nejse ka pasë do cikrrima në mahallë, tash, mos me fol këta rini, e

nijshum çka bojshin në Prishtinë edhe ata e gjujshin naj guri, ata që ishin nëpër rrugë aty, romë, e thejshin naj xhom. Kurgjo domethanë, naj dom të madh jo.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu mandej jeta e juj mas luftës?

Memedali Gradina: Ka vazhdu normal, normal ka vazhdu. Mas luftës normal këtu në Janjevë, po ju tregoj për Janjevë a me dalë jashtë, nejtse, e nijshum na që u kanë pak rrezik me dalë. Ama, këtu në Janjevë... nejtse faleminderit ktyne vllaznive shqiptarvëe këtu, ata na mbrojshin. Kush vijke prej jashtit ju thojshin, “Romët te na mos i ngucni, se na e dina. Na këtu jem rritë, ata kurgjo s’kanë bo. Ata jashtë çka kanë bo në Prishtinë, ata kqyrni”.

Anita Susuri: Me çka jeni marrë pastaj? Çka keni bo?

Memedali Gradina: Po tu i pritë, që i thashë plakit tem, “Këtu bohet Amerika”. Une me qit’ mend që bohet Amerika e vogël, nja një vjet s’kom prekë punën me dorë. Po qata që kena pasë e harxhojshim, kështu edhe kurgjo kërkujna. Edhe tana mas ni vjet, ma së pari u hi shoqja në shkollë me punu. Tana une jom hi me ni kroat me punu aty te maqinat ku nisë prodhimi me fillu. E plaki jem tani e marrke prej Komunës së Lipjanit që u kanë përfaqësues i romëve, i merrke njo 250 euro qashtu diçka e mashallah mirë u kanë. Tana ka nisë jeta mirë. Shoqja rrogë, une rrogë, plaki rrogë, mirë u kanë. Edhe ma mirë bile se tasht. Se tasht veç shoqja punon, na... tana ka fillu mirë, mirë shkojke.

Anita Susuri: Tash me çka merreni, qysh mbijetoni?

Memedali Gradina: Tash po jetojna veç me qat’ rrogën e shoqes. Kjo u maru, kur u maru ma s’ mujna asni baski, që po thojnë, me ngulë dikund po çka me bo. Po elhamdulillah Zoti qysh tha, qashtu. Qato që ka me hangër me pi ka. Qat’ rrogë që merr gruja, penzi që merr nana, e kom djalin e smutë e kom, 120 euro veç barna të tina që duhet me ia ble. Se qat’ smujën që e ka, pa ato barnat s’guxojna me lonë hiç.

Anita Susuri: Çfarë sëmundje është? Në qoftëse bon me ditë.

Memedali Gradina: Jo s’kom pse, allahu e ka falë qashtu. Deri në 17 vjet ai u kanë mirë edhe në shkollë u kanë ma i miri prej klasëve krejt. Po 18 vjeçar ka nisë dora me iu dridhë ma së pari, tani e dyta, është thujse, ni lloj paralizimi ajo. Po, elhamdulillah është në kam të veta po ecë, i smutë është pak tana...

Anita Susuri: Dashta me u kthy pak te festat se harrova me iu pytë për Shëngjergjin, se e di që u festu shumë këtu, jo vetëm me romë po me të gjithë.

Memedali Gradina: Kqyre, përpara ma së pari i bijke Shëngjergji kroatëve, na shkojshim te ata. E mas një jave, po më doket një javë dallim ka pasë Shëngjergji i atyne me Shëngjergjin tonë, tana ata vishin te na. Po përpara s’marojke, Shëngjergji s’u festojke te shpija, po shembull sikur këtu e marojshim ni shator, e thirrshim mysafirë ku jemi kanë na te ata, ata te na. Shëngjergji përpara u kanë festa te na e

madhe, po tasht allahu na ka pru nifarë drejtësie, ishalla e majna qat' drejtësien. Në Janjevë këtu dy-tri shtëpi prej romëve, a e festojnë, a jo?! Une për veti ma kurfarë feste prej që kom nisë me falë pesë vaktet e namazit, normal. Une për veti veç qata dy bajrama, se tjera festa s'kom.

Anita Susuri: E kur u festu Shëngjergji, u festu aty te kinemaja ku ka qenë apo ka pasë ndonjë hapësirë tjetër?

Memedali Gradina: Jo, jo. Aty, nejse qajo hapësira vijke muzika aty. Aty ditën shembull kur vijke muzika normal kcejshum rinia e sene. A kështu festa, festat nëpër shpija, vishin nëpër shpija.

Anita Susuri: A ka pasë ndonjë përgaditje ma përpara për qat' ditë?

Memedali Gradina: Po, po, normal. Ata kingjat i prejshum, i pjekshum, i bojshum. Jo dikush skarë, jo flija, jo sene. Normal, përgaditje ka pasë edhe veshja, qato i kena pasë si tash Bajrami. Ani ma Shëngjergji, bon vaki ma shumë harxhojshim pare. T'nesërmen s'kishim pare as për cigare po qat' ditë, nejse...

Anita Susuri: A keni edhe diçka për fund? Nëse... naj kujtim a diçka që iu ka mbetë?

Memedali Gradina: Nejse, naj kujtim. Çka me thanë? Ajo kujtim, si iu thashë, na kena jetu mirë përpara po qitash osht' qysh osht' duhet me pranu qashtu qysh osht'. Se ka do shokë tash që po dojnë me hi në fe, në qoftëse ka mundësi që liroheni ju. Une po thom, shumica e shokëve veç ata që janë qorr edhe që s'po nijnë, fundi u ardhë para derës e kemi me hi mrena. Se ju kqyrne tash, kurfarë respekti s'ka as baba për djalin, as djali për babën, kurgjo as për kërkon.

Une kur jom kanë i vogël nuk guxojsha me i thonë dikujna që m'çojke me ble cigare me i thanë, "Jo bre s'po shkoj, s'po muj". Jo që m'jepke ai flakareshin, ai po se po, po kur i kallxojke babës tani kush me shku te shpija. Prej tutës, pritsha plaki me ra me flejt tana une me hi mrena. A qitash kqyrne çfarë respekti ka, kijametin hazër e kemi. Kijametin veç allahu e manë shkaku i atyne fëmive t'vogël, se hala s'dijnë kurgjo.

Anita Susuri: Faleminderit shumë për kohën.